



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 1251 prot.

Tiranë, më 11.03.2021

VENDIM

NR. 39, DATË 11.03.2021

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KRITERET DHE MASAT RREGULLUESE
PËR BASHKËPËRDORIMIN E INFRASTRUKTURËS SË TRANSMETIMIT TË
RTSH-SË”**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma “gj” dhe nenit 122 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores “Për kriteret dhe masat rregulluese për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

RREGULLORE

**PËR KRITERET DHE MASAT RREGULLUESE PËR BASHKËPËRDORIMIN E
INFRASTRUKTURËS SË TRANSMETIMIT TË RTSH-SË**

Neni 1

Objekti dhe qëllimi i rregullores

Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së, nga ofruesit e shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv të licencuar për transmetime audio dhe/ose audiovizive tokësore dhe subjektet e licencuar për ofrimin e shërbimit të programit audio/audioviziv.

Neni 2

Përkufizime

Përveç përkufizimeve të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ligj” këtej e tutje nënkupton ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. “Lista e shërbimeve të ofruara” është një listë e publikuar nga RTSH për shërbimet dhe/ose facilitetet që mund t’u ofrohen ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv të licencuar për transmetime audio dhe/ose audiovizive (OSHMA).
3. “Operator përfitues” është OSHM audio dhe/ose audioviziv i licencuar për transmetime audio dhe/ose audiovizive, ose OSHMA i licencuar për ofrimin e shërbimit të programit audio/audioviziv që ka interes për përdorimin e faciliteteve dhe aseteve të RTSH.
4. “Bashkëpërdorim i infrastrukturës” është shërbimi i cili mundëson vendosjen e përshtatshme të pajisjeve të të licencuarit për transmetime audio dhe/ose audiovizive në infrastrukturën e RTSH-së.
5. “Bashkëvendosje fizike” është bashkëvendosja në të cilën pajisja është vendosur në një hapësirë të veçantë nga mjediset ku ndodhen ndërlidhjet e rrjetit të RTSH-së, dhe mbetet nën kontrollin e operatorit përfitues.
6. “Bashkëvendosje në distancë” është bashkëvendosja në të cilën pajisja ndërlidhëse e operatorit përfitues është e instaluar në afërsi të mjedisit ku ndodhen ndërlidhjet e rrjetit të RTSH-së, duke përdorur një transmetues për të realizuar ndërlidhjen fizike.

Neni 3

E drejta e përdorimit të infrastrukturës së RTSH

Një subjekt i licencuar për transmetime audio dhe/ose audiovizive, për ofrimin e shërbimit të programit audio/audioviziv ose subjekt aplikues për licencë audio dhe/ose audiovizive kombëtare, rajonale apo lokale, ka të drejtë të kërkojë përdorimin e mjeteve të infrastrukturës së RTSH-së.

Neni 4

Kërkesa për përdorimin e infrastrukturës së RTSH

1. Kërkesa për përdorimin e infrastrukturës i drejtohet RTSH-së dhe për njoftim AMA-s dhe përfshin nevojat konkrete të operatorit kërkuar sipas listës së shërbimeve të ofruara, hartuar nga RTSH.
2. Kërkesa paraqitet sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
3. RTSH brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, informon me shkrim operatorin përfitues në lidhje me mundësinë ose pamundësinë e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës.

Neni 5

Marrëveshja për përdorimin e infrastrukturës së RTSH-së

1. Nëse RTSH dhe operatori përfitues bien dakord që ky i fundit të përdorë infrastrukturën e RTSH-së, atëherë palët do të nënshkruajnë një marrëveshje dypalëshe.
2. Marrëveshja do të specifikojë mjetet e infrastrukturës që do të përdoren në mënyrë të përbashkët.
3. Marrëveshja duhet të përmbajë të paktën përcaktime në lidhje me:
 - a) Objektivin e marrëveshjes;
 - b) Afatin e vlefshmërisë së marrëveshjes;
 - c) Çmimet/tarifat për përdorimin e infrastrukturës së RTSH-së dhe mënyrën e pagesës së tyre.
 - d) Të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me sigurinë e pajisjeve të instaluara;
 - e) Mënyra dhe procedura për mirëmbajtjen e infrastrukturës së përbashkët;
 - f) Raportimin e problemeve, mënyrën dhe afatet e zgjidhjes së tyre;
 - g) Përfundimin, zgjidhjen dhe anulimin e kontratës;
 - h) Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve;
 - i) Afatin minimal të kohëzgjatjes së marrëveshjes;
 - j) Afatet për shqyrtimin e kërkesave për zgjidhjen apo ndryshimet e kushteve të marrëveshjes.

Neni 6
Marrëveshja Tip për përdorimin e infrastrukturës së RTSH-së

1. Marrëveshja Tip për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës së RTSH do të përgatitet nga RTSH dhe do të dërgohet për mendim në AMA.
2. Në rast se AMA nuk shprehet për përmbajtjen e saj brenda 30 ditësh atëherë kjo marrëveshje do të konsiderohet e pranuar.

Neni 7
Refuzimi i kërkesës

1. RTSH mund të refuzojë kërkesën për përdorimin e infrastrukturës së tij në rast se përdorimi i infrastrukturës është teknikisht i pamundur dhe pengon integritetin e sigurinë e rrjetit të RTSH.
2. Refuzimi i kërkesës nga RTSH, për përdorimin e infrastrukturës duhet të arsyetohet.

Neni 8
Shërbimet e ofruara

1. RTSH, brenda 3 muajve nga miratimi i kësaj rregulloreje përcakton listën e shërbimeve që mund t'u ofrojë ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv të licencuar.
2. Lista e shërbimeve të ofruara duhet të përshkruajë:
 - a) Shërbimet e ofruara, përfshirë:
 - i. Ofrimin e hapësirës në mjediset e pajisjeve të RTSH-së;
 - ii. Vendet e lira në kullat e antenave;
 - iii. Shërbimet e ruajtjes së mjediseve;
 - iv. Shërbimet e mirëmbajtjes;
 - v. Shërbimet e riparimit të defekteve;
 - b) Pikat e bashkëvendosjes dhe pajisjet duke përfshirë:
 - i. vendndodhjen gjeografike të pikave të bashkëvendosjes, me adresat e sakta të tyre;
 - ii. Përshkrim i detajuar teknik i pajisjeve që do të përdoren;
 - iii. Informacion të plotë për pajisjet dhe facilitetet që ofron secila palë.
 - c) Ndryshimet në infrastrukturën e transmetimit.
 - d) Procedurat e faturimit dhe afatet e pagesave.
 - e) Cilësinë e shërbimit, raportimi i defekteve dhe në veçanti:
 - i. Koha mesatare për sigurimin e bashkëvendosjes;
 - ii. Përqindje të ndërprerjeve të transmetimit;
 - iii. Procedura për raportimin e defekteve, periudhën e njoftimit dhe përgjigjes;
 - iv. Përgjegjësitë e të dy palëve për të ndërmarrë masat e duhura për të parandaluar interferencat me rrjetet e tjera, ose ndërprerje të shërbimeve etj.

- f) Përcaktimin e tarifave për çdo shërbim të ofruar dhe procedurën për ndryshimin e tyre përgjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes.

Neni 9

Tarifat e shërbimeve të ofruara

1. Tarifat për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së RTSH-së hartohen bazuar në parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, të orientuara drejt kostos. Tarifat propozohen nga RTSH-ja dhe miratohen nga AMA, e cila shprehet brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimit.
2. Nëse AMA nuk shprehet brenda këtij afati, tarifat konsiderohen të miratuara.
3. RTSH rishikon, sipas nevojave, tarifat për shërbimet e ofruara.

Neni 10

Pagesat e detyrimeve për përdorimin e infrastrukturës së RTSH

1. Pagesat, mënyra dhe afatet e pagesës për përdorimin e infrastrukturës së RTSH-së përcaktohen në marrëveshjen që lidhet midis palëve.
2. Në rast vonesash në pagesa, operatori përfitues, detyrohet të paguajë kamatëvonesë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 11

Shpenzimet për ndërhyrjet në infrastrukturë

Në rastet kur bashkëpërdorimi i infrastrukturës së RTSH kërkon ndryshime në këtë infrastrukturë, shpenzimet mbulohen nga pala, që kërkon përdorimin e infrastrukturës.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kur OSHMA-ja i licencuar për transmetime audio dhe/ose audiovizive ose i licencuar për ofrimin e shërbimit të programit audio/auiovizive dhe RTSH kanë mosmarrëveshje gjatë vlefshmërisë së marrëveshjes lidhur me bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së, AMA, me kërkesë të çdo pale, ndërmerr një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas parashikimeve të ligjit.
2. Kundër vendimit të AMA-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, palët kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës kompetente.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga AMA.

Neni 14 Publikimi

Kjo rregullore publikohet në faqen zyrtare të internetit www.ama.gov.al.

ANEKSI 1

Formular mbi bashkëvendosjen ose/dhe përdorimin e përbashkët të infrastrukturës së RTSH

<i>Të dhëna të përgjithshme mbi operatorin përfitues</i>	
Emri i operatorit përfitues: Person Fizik/Sh.p.k/Sh.a.	
NIPT:	
Emri i OSHMA-së:	
Përfaqësuesi ligjor:	
Adresa postare e selisë:	
Nr. Tel/Mob:	
Zona e mbulimit:	<input type="checkbox"/> Lokale <input type="checkbox"/> Rajonale <input type="checkbox"/> Kombëtare
Qarku/ Bashkia/ Njësia Administrative	

<i>Të dhëna mbi instalimin</i>	
Emri i pikës së transmetimit të RTSH:	Numri ID i pikës së transmetimit nëse ka:
Lloji i aplikimit:	<input type="checkbox"/> Shërbim i ri <input type="checkbox"/> Shërbim shtesë <input type="checkbox"/> Ripozicionim
Tipi i shërbimit:	<input type="checkbox"/> Digital TV <input type="checkbox"/> AM Radio <input type="checkbox"/> FM Radio <input type="checkbox"/> Digital Radio <input type="checkbox"/> Akses (mbartje) <input type="checkbox"/> Tjetër
Transmetime:	<input type="checkbox"/> Tregtare <input type="checkbox"/> Komunitare <input type="checkbox"/> Tjetër
Licenca e transmetimeve audio/audiovizive lëshuar nga AMA:	Nëse po, bashkëlidhja këtij formulari
Data e propozuar e daljes në transmetim (On air):	

<i>Pajisjet e propozuara për përdorim të përbashkët</i>	
Pajisjet që do të dëshironit të bashkëpërdorni:	<input type="checkbox"/> Antena <input type="checkbox"/> Kulla <input type="checkbox"/> Ambjente <input type="checkbox"/> Rack <input type="checkbox"/> Antenë satelitore (Dish) <input type="checkbox"/> Antenë Marrëse
Dëshironi të lidheni me impiantin e	<input type="checkbox"/> PO <input type="checkbox"/> JO

energjisë elektrike të RTSH?		
Për të përcaktuar nevojat e energjisë, lutemi përcaktoni çdo pajisje shtesë që do të instaloni?	<input type="checkbox"/> Nuk ka <input type="checkbox"/> Kondicioner <input type="checkbox"/> Lëngështues <input type="checkbox"/> Tjetër	nëse është në kategorinë "Tjetër" specifikoje

Hapësira e kërkuar në kullë në bashkëpërdorim me RTSH					
Antena	Modeli	Lartësia (m)	Polarizimi (V/H)	Azimuth (°)	Tilt (°)
*					

*Specifiko Rx ose Tx

Pajisjet në ndërtesën e RTSH							
Lloji pajisjes (p.sh. Tx, Rx, Rack-e, pajisje të tjera)	Modeli	Zona (m2)	Frekuenca	Fuqia e transmetuesit (W)	Fuqia në dalje e transmetuesit (W)	ERP (W)	Konsumi energjisë (kW/h)

Të dhëna plotësuese:
Listoni të gjitha dimensionet dhe vendet e propozuara të çdo pajisje tjetër që do të instalohet p.sh. Saç satelitor dish etj

Planimetria: (bashkëlidhur këtij formulari)
Planimetria ekzistuese e site-it do të bëhet nga RTSH. Aplikanti ka për detyrim të përditësojë këtë planimetri, me qëllim pasqyrimin e instalimit të shërbimit të kërkuar.

Subjekti (Person Fizik/ Person Juridik)

(Firma, Vula)

Data _____